



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 39

2001

Korrik

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 452, datë 28.6. 2001	Për miratimin e procedurave të privatizimit dhe të termave të kontratës së shitjes të aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a... 1231
Vendim i KM nr.457,datë 28.6.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.403, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për rritjen e pensioneve suplementare” 1242
Vendim i KM nr.458, datë 28.6.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.7392, datë 17.5.1995; nr.8286, datë 16.2.1998; nr.8392, datë 2.9.1998; nr.8575, datë 8.2.2000; nr.8776, datë 26.4.2001 dhe ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”..... 1243

Vendim i KM nr. 459, datë 28.6.2001	Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Komisionit Kombëtar Ndërministror të luftës kundër HIV/AIDS (SIDA)”...	1244
Vendim i GJK nr. 58, datë 3.7.2001	Me objekt shfuqizimin e pavlefshmërisë së vendimit nr.008, datë 30.5.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.....	1247

V E N D I M
Nr.452, datë 28.6. 2001

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT DHE TË TERMAVE TË KONTRATËS SË SHITJES SË AKSIONEVE TË BANKËS SË KURSIMEVE SH.A.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.”, i ndryshuar me ligjin 8806, datë 17.5.2001, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e procedurave të privatizimit dhe të termave të kontratës së shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a., sipas dokumenteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta

PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I. TË PËRGJITHSHME

1. Përzgjedhja e investitorit strategjik për shitjen e jo më pak se 35% (tridhjetë e pesë për qind) dhe deri në 100% (njëqind për qind) të aksioneve të Bankës së Kursimeve të Shqipërisë bëhet me tender të hapur ndërkombëtar. Pronësia e aksioneve të Bankës së Kursimeve i transferohet investitorit strategjik, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 2 të ligjit nr. 8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.”. Investitorët strategjikë të jenë banka që kanë licencë për të zhvilluar veprimtari bankare dhe zhvillojnë në përputhje me legjislationin e juridiksionit ku ndodhet selia e tyre. Tenderi i hapur ndërkombëtar për shitjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve kryhet në 3 faza:

a. Parakualifikimi

Parakualifikimi bëhet në bazë të dokumenteve dhe kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në Aneksin I dhe II të këtij Dokumenti. U dërgohet ftesë për tender vetëm të interesuarve që grumbullojnë 70 (shtatëdhjetë) ose më shumë pikë në vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur prej tyre për parakualifikim.

b. Vlerësimi i ofertave

Vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje me dokumentet dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuara në Aneksin III të këtij Dokumenti.

c. Përzgjedhja dhe shpallja e fituesit

Përzgjedhja e fituesit bëhet nga Ministri i Financave, mbështetur në listën e renditjes së ofertuesve që i paraqet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe fituesi shpallet përfundimisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ministri i Financave përgatit dokumentacionin dhe zhvillon tenderin, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Dokument.

3. Aksionet që nuk blihen nga investitori strategjik sipas procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar dhe pikës 1 të këtij Dokumenti u ofrohen për blerje institucioneve financiare ndërkombëtare ose personave fizikë ose juridikë shqiptarë, sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 2 të ligjit nr. 8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.” ose mund të vazhdojnë të mbahen nga shteti, përfaqësuar nga Ministri i Financave.

II. Procedurat e Tenderit

1. Fillimi i procedurave të privatizimit bëhet pas dhënies së miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë në përputhje me ligjin 8365, datë 2.7.1998 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Njoftimi i të interesuarve për paraqitjen e dokumenteve për parakualifikim botohet një herë në: “Financial Times”, “The Economist”, në katër gazeta të huaja, si dhe në katër numra të njëpasnjëshëm të katër gazetave shqiptare me tirazh të gjerë. Nëse nevojitet, do të bëhen njoftime shtesë. Data për paraqitjen e dokumentacionit për parakualifikim përcaktohet në njoftim dhe është jo më vonë se 15 ditë nga data e njoftimit të fundit. Njoftimi për parakualifikim përmban:

emrin e shitësit;

numrin e aksioneve që vihen në shitje;

një përmbledhje të arsyes së njoftimit;

synimet e transaksionit dhe baza ligjore e kryerjes së tij;

një përshkrim të shkurtër të Bankës së Kursimeve;

procedurat që duhet të ndiqen me marrjen e njoftimit;

adresat e kontaktit.

3. Të interesuarit të jenë banka ose bashkim bankash. Në rastin e bashkimit, kërkesa për parakualifikim përshkruan qartë marrëdhëniet midis pjesëmarrësve në të dhe të tregojë përgjegjësitë e tyre përkatëse, si dhe të ketë bashkëngjitur një kopje të marrëveshjes së bashkimit.

4. Ndonjë ose të gjithë të interesuarit mund të skualifikohen ose të përjashtohen nga procedurat e mëtejshme, ndër të tjera, për arsyet e mëposhtme:

a) Nuk paraqesin dokumentacion të plotë brenda afatit të caktuar për parakualifikim.

b) Informacioni që përmbajnë materialet e dërguara prej tyre ka mangësi, pasaktësi ose mospërputhje.

5. Të interesuarit dorëzojnë kërkesën për parakualifikim bashkë me dokumentet e përcaktuara në Aneksin I të këtij Dokumenti.

6. Parakualifikimi bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Aneksin II të këtij Dokumenti.

7. Ministri i Financave u dërgon ftesë për tender vetëm të interesuarve që kualifikohen. Ftesa për tender përmban:

emrin e Bankës që privatizohet dhe vendndodhjen e saj;

numrin e aksioneve që vihen në shitje;

forma e tenderit;

formula përkatëse e privatizimit;

pagesën për marrjen e Memorandumit të Informacionit dhe dokumenteve përkatëse;

kushtet për garantimin e ofertës dhe afatin përfundimtar për vlefshmërinë e ofertës;

adresën dhe afatin për të tërhequr dokumentet e tenderit

vendin, mënyrën dhe datën e dorëzimit të ofertave dhe hapjen e tyre.

8. Ofertat paraqiten brenda afatit të përcaktuar në ftesën për tender dhe përmbajnë dokumentet e përcaktuara në Aneksin III të këtij Dokumenti.

9. Vlerësimi i ofertave bëhet në përputhje me rregullat e procedurën e përcaktuar në Aneksin III të këtij Dokumenti.

III. Procedurat për kalimin e pronësisë së aksioneve

1. Oferta më e mirë e paraqitur përcaktohet në përputhje me kriteret e vlerësimit. Ministri i Financave, pas marrjes nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të raportit dhe listës së renditjes së tyre, ia paraqet listën me renditjen e ofertuesve, si dhe ofertën e fituese për miratim përfundimtar Këshillit të Ministrave.

2. Ministri i Financave zhvillon bisedime me ofertuesin e renditur i pari në listë, si dhe me ofertues të tjerë, pas miratimit të tyre si fitues nga Këshilli i Ministrave. Gjatë kohës së zhvillimit të këtyre bisedimeve ofertuesi dorëzon raportet e due diligence të përgatitur prej tij.

3. Nënshkrimi në parim i marrëveshjes me ofertuesin e përzgjedhur do të thotë e drejtë për transferimin e pronësisë së aksioneve të Bankës së Kursimeve, në përputhje me paragrafet e mëposhtëm.

4. Transferimi i pronësisë kryhet pas miratimit përfundimtar të Bankës së Shqipërisë në përputhje me ligjin nr.8365, datë 2.7.1998 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

5. Nënshkrimi i kontratës përfundimtare ndërmjet Ministrit të Financave dhe ofertuesit të shpallur fitues është transferim i së drejtës së pronësisë të aksioneve ofertuesit fitues.

6. Me kërkesë të Ministrit të Financave, çdo aplikant duhet të deklarojë vlefshmërinë e përmbajtjes së ofertës ose të paraqesë informacione shtesë ose shpjegime të ofertës së tij.

IV. DORËZIMI DHE HAPJA E OFERTAVE

1. Oferta dërgohet në vendin e përcaktuar në ftesën për tender dhe dorëzohet përpara datës dhe kohës së hapjes së ofertave. Ofertat paraqiten në gjuhën angleze dhe janë të mbyllura në zarf. Ofertat paraqiten në katër ekzemplarë, një prej të cilëve origjinal. Zarfet janë të vulosur dhe mbi to shënohet emri i aplikantit dhe shënimi “origjinal” ose “kopje”, sipas rastit. Çdo faqe e dokumenteve që ka dosja në “origjinal” nënshkruhet nga personi i autorizuar rregullisht nga aplikanti.

2. Një aplikant dorëzon vetëm një ofertë.

3. Ofertat e dorëzuara përmbajnë një deklaratë, nëpërmjet të cilës aplikanti zotohet se:

a) pranon kushtet e përcaktuara në ftesën për tender;

b) do të paguajë çmimin e paraqitur në ofertë;

c) merr përsipër të kryejë pagesat dhe të respektojë kërkesat e tenderit.

4. Dorëzimi dhe hapja e ofertave kryhet në përputhje me këtë Dokument. Pas kësaj përcaktohen ofertat e vlefshme. Të gjitha ofertat e vlefshme vlerësohen në mënyrë të plotë.

Shpenzimet për përgatitjen e ofertës dhe për kryerjen e procedurave të tenderit përballohen nga ofertuesit.

V. KONFIDENCIALITETI

Aplikantëve (ofertuesve) të mundshëm duhet t'u kërkohe që të nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti në formë dhe përmbajtje, e cila gjykohe e kënaqshme nga ana e Ministrisë së Financave.

VI. KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

1. Ministri i Financave është anëtar dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. Anëtarë të tjerë të këtij Komisioni janë:

a) tri përfaqësues nga Ministria e Financave, një ndër të cilët me detyrën e sekretarit, të caktuar nga Ministri i saj;

b) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, i caktuar nga Ministri i saj;

c) një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, i caktuar nga Kryeministri;

d) dy përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, të caktuar nga Ministri i saj;

e) një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, i caktuar nga Kryetari i saj.

3. Ministri i Financave cakton në Komision një këshilltar të pavaruar, të huaj, si anëtar pa të drejtë vote.

4. Të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nënshkruajnë një deklaratë, me anë të së cilës dëshmojnë se nuk kanë lidhje gjaku, veprimtarie tregtare apo interesa të tjera me ofertuesit.

5. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, me përjashtim të këshilltarit të huaj të pavarur, shpërblehen me dy paga mujore, sipas pagës që kanë në çastin e dhënies së shpërblimit.

6. Nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

a) personat që përfaqësojnë ose kanë interesa të drejtpërdrejta me ofertuesit ose bashkëpunojnë me ofertuesit;

b) punonjësit ose anëtarët e Këshillit Drejtues të Bankës së Kursimeve;

c) bashkaksionerët ose aksioneri i vetëm i ofertuesve ose pjesëtarët e ndonjë bashkimi ofertuesish.

7. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbajnë të fshehtë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me procesin e tenderit dhe ofertuesit dhe e përdorin informacionin e marrë vetëm për vlerësimin e ofertave.

8. Gjatë tërë procesit të tenderit dhe të privatizimit të Bankës së Kursimeve, Ministri i Financave, në bashkëpunim me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave:

- a) koordinon veprimet për të siguruar transparencë dhe objektivitet të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në lidhje me privatizimin e Bankës së Kursimeve;
- b) përgatit informacionin dhe materialet e tjera të nevojshme për shpërndarjen e tyre investitorëve të interesuar në bazë të një marrëveshjeje konfidenciale të nënshkruar;
- c) bën paraqitjen e Bankës së Kursimeve;
- d) bën njoftimin për parakualifikim, sipas kriterëve të përcaktuara në Aneksin I të këtij Dokumenti;
- e) bën parakualifikimin e të interesuarve dhe u dërgon ftesën për tender atyre që kalojnë parakualifikimin;
- ë) përcakton ofertën më të mirë, në përputhje me kriteret e vlerësimit, dhe ia paraqet Këshillit të Ministrave për miratim përfundimtar;
- f) zhvillon bisedime me ofertuesin e miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe me ofertues të tjerë, sipas rastit;
- g) nënshkruan në parim marrëveshjen me ofertuesin e miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe çdo ofertues tjetër, sipas rastit;
- gj) përcakton kushtet dhe afatet e kontratës përfundimtare të shitjes;
- h) i jep dokumentet e kërkuara dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm Bankës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.8365, datë 2.7.1998 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- i) nënshkruan kontratën përfundimtare të shitjes;
- j) bën kalimin e pronësisë së aksioneve, në përputhje me kushtet dhe afatet e kontratës së shitjes.

VII. PROCEDURAT E VLERËSIMIT Të OFERTAVE

1. Gjatë hapjes dhe vlerësimit të ofertave, Komisioni për Vlerësimin e Ofertave mund të kërkojë nga ofertuesit informacion ndihmës për vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Pyetjet dhe përgjigjet e ofertuesve në lidhje me ofertat bëhen me shkrim dhe regjistrohen. Ato nuk interpretohen si ndryshim i kushteve. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kryen vlerësimin e ofertave në këtë mënyrë:

1.1 Çdo anëtar i Komisionit bën vlerësim të pavarur për çdo ofertë duke përdorur pikët sipas kriterëve të përcaktuara për çdo ofertë në Aneksin III të këtij dokumenti. Anëtarët e komisionit plotësojnë një formular të përgatitur për këtë qëllim nga Komisioni.

1.2 Pas mbledhjes së pikëve, ofertat radhiten duke filluar nga ajo me pikë më të larta.

2. Gjatë procesit të vlerësimit Komisioni vepron si më poshtë:

2.1 Krahason ofertat duke u bazuar në kriteret dhe rëndësinë e specifikuar në ftesën për tender, sipas dispozitave të këtij vendimi. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë vlerësim me shkrim edhe nga pjesëmarrësit e Komisionit pa të drejtë vote, i cili mund të nevojitet për vlerësimin e një çështjeje të veçantë.

2.2 Më pas, Komisioni përgatit raport me shkrim mbi vlerësimin e ofertave. Ky raport përmban:

- a) objektin e ofertës dhe numrin e aksioneve të vëna në shitje;
- b) përmbledhje të procedurës dhe numrin e ofertave të paraqitura;
- c) përmbledhje të ofertave të paraqitura;
- d) kriterin kryesor të vlerësimit të ofertës dhe mendime për oferta të veçanta;
- e) kriterin që përcakton çmimin e shitjes;
- f) përmbledhje të rezultateve të procedurave të tenderit, së bashku me listën e aplikanteve (ofertuesve) që rezultojnë nga vlerësimi i ofertave.

VIII. DEKLARIMI I OFERTAVE Të PAVLEFSHME OSE Të PASUKSESSHME

1. Një ofertë është e pavlefshme kur:

- a) ofertuesi nuk ka dhënë garanci oferte;
- b) ofertuesi shkel detyrimin për konfidencialitetin e tenderit;
- c) një deklaratë e ofertuesit bie në kundërshtim me kushtet e tenderit;
- d) ofertuesi nuk respekton rregullat e tenderit në tërësi.

2. Oferta ashtu si dhe tenderi konsiderohet i pasuksesshëm në rast se:

- a) asnjëra prej ofertave nuk kënaq kërkesat e ftesës për tender;
- b) kërkesa të tjera nuk përmbushin qëllimin e tenderit;
- c) Këshilli i Ministrave nuk miraton shitjen e aksioneve.

Në rast se Këshilli i Ministrave nuk miraton shitjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a. Ministria e Financave ka të drejtë të rifillojë procedura të reja për shitjen e aksioneve, në përputhje me kriteret e parashikuara në këtë vendim.

IX. MARRJA E VENDIMIT DHE NXJERRJA E REZULTATEVE Të TENDERIT

1. Vlerësimi i ofertave dhe nxjerrja e rezultatit bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

2. Në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe në ftesën për tender, vlerësimi i ofertave bëhet brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave. Në raste të veçanta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të shtyjë afatin e vlerësimit të ofertave për 5 (pesë) ditë të tjera dhe ua njofton shtyrjen ofertuesve.

3. Përveç fituesit, vendimi për rezultatin e tenderit mund të përmendë edhe ofertuesin e vendit të dytë dhe të tretë, me të cilët Ministri i Financave ka të drejtë të nënshkruajë kontratën në rast se fituesi nuk mundet ose nuk pranon kushtet e kontratës.

4. Ministri i Financave u njofton të gjithë ofertuesve rezultatet e tenderit brenda 5 ditëve nga dita e vlerësimit të ofertave.

5. Brenda 7 ditëve nga mbyllja e tenderit dhe njoftimit të rezultateve, Ministri i Financave harton një projektvendim dhe raportin përkatës bashkë me dokumentacionin e plotë të tenderit dhe ia dorëzon atë për shqyrtim dhe miratim Këshillit të Ministrave.

X. NËNSHKRIMI I KONTRATËS

1. Kontrata me fituesin nënshkruhet nga Ministri i Financave vetëm pasi Këshilli i Ministrave të ketë miratuar fituesin dhe projektkontratën.

2. Kontrata nënshkruhet brenda 3 javëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave.

3. Në rast se:

- a) kontrata nuk nënshkruhet nga ofertuesi i shpallur fitues i tenderit;
- b) kontrata zgjidhet nga Ministri i Financave për shkak të mospërmbushjes së kushteve të saj nga fituesi; ose
- c) Kontrata zgjidhet me marrëveshje të palëve,

Ministri i Financave nënshkruan kontratën me ofertuesin e renditur në vendin e dytë.

4. Kontrata me fituesin e tenderit hyn në fuqi vetëm pas miratimit të saj përfundimtar nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.8365, datë 2.7.1998 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

ANEKSI I PARAKUALIFIKIMI

A. OBJEKTIVAT E PARAKUALIFIKIMIT

Objektivi i fazës parakualifikuese është tërheqja për të paraqitur oferta e një numri të mjaftueshëm investitorësh të mundshëm, duke mundësuar Ministrinë e Financave që të marrë oferta nga persona juridikë me përvojë në sektorin bankar. Ministria e Financave dëshiron të tërheqë aplikantë që kanë përvojë zhvillimi, menaxhimi dhe ushtrimi të veprimtarisë bankare. Në qoftë se një aplikant nuk ka eksperiencë të mjaftueshme në ndonjë prej fushave specifike, ai mund të lidhet me individë ose shoqëri me përvojë.

Aplikantët duhet të demonstrojnë aftësinë e tyre për të financuar blerjen dhe për të zhvilluar bankën në të ardhmen. Në qoftë se një aplikant është i lidhur me individë ose shoqëri të tjera, atëherë duhet të paraqiten emrat, të dhëna për përvojën dhe historinë, si dhe gjendja financiare e tyre, natyra e lidhjes me këta individë apo shoqëri.

Aplikantët duhet të paraqesin dokumente provuese se kanë brenda tyre aftësi teknike dhe mundësi për të administruar nevojat e parashikuara për zgjerimin dhe rihvillimin e Bankës së Kursimeve.

B. DOKUMENTET

I. Deklaratë zyrtare për gjendjen e aplikantit

Me anë të këtij dokumenti të lëshuar para organit kompetent në shtetin ku ka selinë e vet, përfaqësuesi i ligjshëm i aplikantit do të deklarojë me përgjegjësi për gjendjen e aplikantit dhe se gjithçka që do të paraqitet është e vërtetë dhe e saktë.

II. Të dhëna bazë

1. Dokumente zyrtare të lëshuara nga organet përkatëse vërtetojnë regjistrimin dhe gjendjen aktuale të aplikantit, që përfshijnë emrin, selinë, organet drejtuese, kapitalin, afatin dhe llojin e veprimtarisë dhe çdo të dhënë tjetër të kësaj natyre;

2. Kopje të vërtetuara të Aktit të Themelimit e të Statutit, me ndryshimet përkatëse, nëse ka;

3. Llogaritë e audituara të 3 (tre) viteve ushtrimore të fundit, të audituara nga shoqëri të njohura ndërkombëtare;

4. Vërtetim që tregon se:

- totali i aktiveve të bankës është jo më i vogël se 4 miliard dollarë amerikanë;

- vlera neto e bankës është jo më e vogël se 500 milion dollarë amerikanë;

5. Vërtetim se përvoja në fushën bankare është jo më pak se 10 vjet;

6. Vërtetim se aplikanti ushtron veprimtari edhe jashtë vendit ku ka selinë;

7. Dokumenti i lëshuar nga aplikanti që tregon numrin e përafërt të aksioneve që propozon të blejë.

III. Informacion nga bashkimet e aplikantëve që nuk kanë themeluar person juridik të regjistruar

Bashkimet e aplikantëve që nuk kanë themeluar person juridik të regjistruar të paraqesin për secilin anëtar dokumentacionin, sipas nënseksioneve I dhe II të seksionit B këtij Aneksi.

C. UDHËZIME PËR PARAQITJEN E DOKUMENTEVE

a) Një (1) origjinal dhe tre (3) kopje të dokumenteve parakualifikuese të aplikantit të dërgohen brenda afatit të caktuar.

b) Aplikimi bashkë me dokumentet e parakualifikimit të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Ministri i Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri.

c) Dokumentet parakualifikuese që do të merren pas datës së fundit të afatit përfundimtar të kësaj faze nuk shqyrtohen dhe kandidatit i njoftohet kjo gjë.

D. TRAJTIMI I APLIKIMEVE

Ministri i Financave do të informojë secilin prej aplikantëve për rezultatin e propozimit të tij për parakualifikimin. Ministri i Financave rezervon të drejtën të pranojë ose të mos pranojë kërkesën për parakualifikim të çdo aplikanti, pa i lindur ndonjë detyrim ndaj aplikantëve të cilëve nuk u pranohet kërkesa. Ministri i Financave rezervon të drejtën e mosdhënies ose të përfundimit të ndonjë kontrate ose marrëveshjeje me secilin prej aplikantëve dhe mund të mbyllë procesin e parakualifikimit në çdo kohë, duke mos shkaktuar në këtë mënyrë asnjë lloj detyrimi ndaj çdo aplikanti.

E. PROCEDURAT E VLERËSIMIT PARAKUALIFIKUES

1. Aplikantët do të vlerësohen në kategori të ndryshme dhe do të renditen. Aplikantët e renditur të parët do të zgjidhen si aplikantët e parakualifikuar. Ministri i Financave synon të zgjedhë 6 (gjashtë) aplikantë të parakualifikuar, por ka të drejtë që ta ndryshojë këtë numër me bindjen e vet.

2. Secili ose të gjithë aplikantët mund të skualifikohen nga parakualifikimi dhe të përjashtohen nga shqyrtimi i mëtejshëm, ndër të tjera, kur:

- a) dokumentet parakualifikuese paraqiten pas datës përfundimtare të caktuar;
- b) dokumentet mbështetëse nuk paraqiten brenda datës së caktuar;
- c) dokumentet parakualifikuese, si dhe të dhënat e tjera nuk paraqiten në mënyrën e kërkuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
- d) ka mospërputhje thelbësore në informacionin e paraqitur;
- e) në dokumentet parakualifikues dhe dokumentet mbështetëse gjenden deklarime qëllimisht të pasakta.

3. Aplikantët parakualifikohen sipas një shkallë me 100 pikë maksimale dhe kriteri minimal për parakualifikim është 70 pikë.

4. Më hollësisht, kriteret e vlerësimit jepen në tabelën e Aneksit II.

ANEKSI II KRITERET E VLERËSIMIT PËR PROCESIN E PARAKUALIFIKIMIT

KRITERET E PARAKUALIFIKIMIT	PIKËT MAKSIMALE				
Cilësitë e kandidatit	32				
Aftësia financiare	45				
1. Gjendja financiare, performanca dhe aftësia	50 % të 45 pikëve				
2. Aftësia e huamarrjes	30 % të 45 pikëve				
3. Aftësia për sigurim kapitalesh	20 % të 45 pikëve				
Suksesi si investitor strategjik në sektorin bankar	23				
TOTALI	100				

ANEKSI III PROCEDURAT TENDERIT DHE DOKUMENTET E OFERTAVE

A. Procedura

Ofertat duhet të paraqiten në gjuhën angleze dhe duhet të përfshijnë informacionin që kërkohet në këtë aneks.

Propozimi financiar do të mbulojë deri 65% të pikëve; propozimi teknik do të mbulojë pjesën e mbetur 25% dhe madhësia e investitorit do të mbulojë 10 % të pikëve. Rezultati i përgjithshëm do të jetë shuma e të tre vlerësimeve.

Kriteret e vlerësimit të ofertave mund të përpunohen ose të detajohen më tej nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përpara ftesës në tender.

Në dokumentet e tenderit ndodhen një sërë udhëzimesh për zbatimin e rregullave të tenderit nga ofertuesit. Zbatimi i këtyre rregullave do të jetë dhe pika e parë që do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Nëse do të identifikohet ndonjë shmangie, atëherë aplikantët do të njoftohen rreth kësaj.

Ofertat do të paraqiten të mbyllura në zarfe të mbyllur, të ndara në ofertë teknike edhe ofertë financiare.

5. Të gjithë ofertuesit duhet ta trajtojnë konfidencial informacionin që mbledhin ndërsa kryejnë due diligence.

B. Informacioni që duhet dorëzuar

1. Ofertuesi i vetëm të paraqesë në ofertë:
 - a) autorizim të personit që ka tagra të plota ta angazhojë atë para Ministrin të Financave;
 - b) dokument nga autoriteti mbikëqyrës i kandidatit që jep miratimin për të blerë aksione të Bankës së Kursimeve sh.a.;
 - c) deklaratë se nuk ndodhet në gjendje falimentimi ose në prag të saj dhe se nuk është i paditur në ndonjë proces domethënës gjyqësor;
 - d) autorizimin e lëshuar së fundmi nga autoriteti mbikëqyrës i vendit të tij që i ka dhënë të drejtën të kryejë veprime pranimi dhe grumbullimi të depozitave në para ose fonde të tjera të ripagueshme, në vendin ku ndodhet selia e saj qendrore që tregon se kandidati ka qenë i mbikëqyruar dhe se është në gjendje të mirë;
 - e) raportet vjetore financiare për shtatë vitet e fundit;
 - f) dokument vërtetues (certifikatë) nga autoritetet përkatëse që vërteton se aplikanti nuk ka detyrime tatimore të pashlyera;
 - g) deklaratë se pranon pa asnjë rezervë kushtet dhe afatet e tenderit;
 - h) raport vjetor i vitit të fundit i shoqërive në të cilat ka pjesëmarrje domethënëse;
2. Në rast bashkimi ofertuesish, përveç dokumenteve të mësipërme që duhet të paraqiten për çdo anëtar të tij, duhet të paraqiten edhe këto dokumente:
 - a) marrëveshja e bashkimit ose dokumentin e regjistrimit të bashkimit si person juridik më vete;
 - b) dokument që tregon udhëheqësin dhe përfaqësuesin e bashkimit;
 - c) deklaratë e secilit anëtar të bashkimit se ata përgjegjen solidarisht përpara Ministrin të Financave.

C. Dorëzimi i ofertave

Përmbajtja dhe formati i pjesës financiare dhe teknike e ofertës duhet të përgatiten (hartohen) në përputhje me tabelat e mëposhtme.

1. Për anën financiare

1.1 Në ofertën financiare ofertuesit duhet të përfshijnë propozimet, sipas tabelës së mëposhtme:

Emri	Vlera	Afati kohor i propozuar	Pikët
A. Blerje aksionesh			53
B. Burimet të cilat aplikanti zotohet se do t'i verë në dispozicion me qëllim zbatimin e biznesplanit			12

1.2 Të gjitha ofertat që përfshijnë plan-investimi ose pagesë me këste do t'iu bëhet zbritje me normën e Bonos së Qeverisë Gjermane plus 1%. Koha e maturimit të bonos varet nga data e transferimit të fondeve të planifikuara për pagesë. Për shembull, nëse do të investohet gjatë tre vjetëve, atëherë vlera aktuale e tyre do të përcaktohet duke përdorur normën e aplikueshme mbi Bondet gjatë tre vjeteve.

1.3 Përparësi do t'u jepet blerësve që paguajnë të gjitha ose pjesën më të madhe të shumave në çastin e nënshkrimit të kontratës ose që i përgjigjen objektivit të Qeverisë për shitjen e mbi 50% (pesëdhjetë për qind) të aksioneve.

1.4 Përshkrimin me hollësi të ngjarjeve që mund të çojnë në pretendimin e forcës madhore.

2. Për anën teknike

Emri	Pikët
Plan biznesi i detajuar	8
Plan i hollësishëm rristrukturimi, duke përfshirë trajtimin e propozuar të stafit dhe atë	14

të degëve. Ky plan duhet të përfshijë trajtimin e pritshëm të personelit dhe atë të degëve.	
Curricula Vitae të plota të gjithë stafit kyç menaxhues që do të përfshihet, së bashku me detaje të roleve të tyre	3

3. Për madhësinë e investitorit.

	4-12 miliard USD	12-20 miliard USD	mbi 20 miliard USD
A. Totali i aseteve	1 pikë	2 pikë	5 pikë
	0.5-1 miliard USD	1-1.5 miliard USD	mbi 1.5 miliard USD
B. Vlera neto e Bankës	1 pikë	2 pikë	5 pikë
Totali A + B	2 pikë	4 pikë	10 pikë

TERMAT KRYESORË TË KONTRATËS SË TRANSFERIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI AKSIONET E BANKËS SË KURSIMEVE SH.A. NËPËRMJET SHITJES

Ky dokument përmban në mënyrë të përmblodhur kushtet kryesore të Kontratës së Shitjes së Aksioneve që do të lidhet për Bankën e Kursimeve të Shqipërisë (Banka e Kursimeve). Kontrata e Shitjes së Aksioneve do të hartohet në bazë të këtyre kushteve. Në fakt, kjo përmbledhje e kushteve të Kontratës nuk është me fuqi detyruese në këtë fazë dhe nuk përmban të gjitha kushtet që do të përfshihen në kontratën përfundimtare të shitjes së aksioneve. Palët do të hartojnë Kontratën përfundimtare të Shitjes së Aksioneve, e cila do të lidhet si kontratë me efekte detyruese, pasi të jenë dhënë miratimet përkatëse nga ana e Qeverisë dhe të Bankës së Shqipërisë.

Kontratë	Kontrata e Shitjes së Aksioneve që propozohet për t'u lidhur për blerjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a.
Palët	Palët në kontratë janë Ministri i Financave (shitësi) dhe investitori/ët (blerësi) që do të blejë aksionet e Bankës së Kursimeve sh.a.
Objekti i kontratës	Transferimi i së drejtës së pronësisë nëpërmjet shitjes deri njëqind për qind të kapitalit dhe aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a. (aksionet).
Deklarimet dhe garancitë e shitësit	<p>Shitësi i bën blerësit deklaratimet e mëposhtme:</p> <p>Privatizimi i Bankës është bërë në përputhje me legjislacionin shqiptar të privatizimeve dhe vendimet e Këshillit të Ministrave.</p> <p>Përzgjedhja e investitorit strategjik është bërë në përputhje me ligjet e privatizimit dhe vendimet e Këshillit të Ministrave.</p> <p>Banka është shoqëri anonime e krijuar dhe që funksionon në mënyrë të ligjshme, e cila ka kompetenca të plota të përdorë ose të zotërojë pasuritë e saj dhe të kryejë veprimtarinë e saj.</p> <p>Shitësi ka titull pronësie mbi aksionet. Të gjitha aksionet janë emetuar në mënyrë të vlefshme dhe janë shlyer tërësisht. Nuk ka opsione, garanci ose instrumente të tjerë të konvertueshëm në aksione ose marrëveshje të tjera për emetimin e ndonjë aksioni të çfarëdo grupi ose lloji. Asnjë letër me vlerë e Bankës nuk është drejtpërdrejt ose tërthorazi e konvertueshme ose e shkëmbyeshme me aksionet e Bankës.</p> <p>Në çastin që do t'i kalohen blerësit aksionet janë nënshkruar dhe emetuar rregullisht, janë shlyer tërësisht dhe janë të lira nga çdo lloj barre apo detyrimi.</p>

Nuk ka asnjë garanci të mbetur, opcion ose të drejta të tjera për blerjen ose të drejta parablerjeje në lidhje me emetimin ose shitjen e aksioneve.

Leja e Bankës së Kursimeve për ushtrim veprimtarie bankare është dhënë dhe mbahet nga Banka e Kursimeve sh.a. në mënyrë të ligjshme.

Me përjashtim të sa përshkruhet në shtojcën bashkëngjitur Kontratës, Banka e Kursimeve sh.a. nuk zotëron shoqëri të kontrolluara.

Me përjashtim të sa përshkruhet në shtojcën bashkëngjitur Kontratës, Banka ka pronësi të plotë dhe të qartë mbi tokën dhe ndërtesat që renditen në gjendjen e saj financiare të paraqitur.

Deklarimet dhe garancitë e dhëna nga blerësi

Blerësi duhet të deklarojë dhe garantojë, ndër të tjera, se: ka autoritetin e nevojshëm për të lidhur dhe zbatuar kushtet e Kontratës; zbatimi i kushteve të Kontratës nuk do të pengohet nga ndonjë marrëveshje ose dokument tjetër ku ai është palë.

Zotimet e blerësit

Blerësi merr përsipër të gjitha detyrimet sipas zakonit të mirë tregtar dhe merr përsipër, gjithashtu, që: të kryejë investimin, trajnimin dhe programe asistence, siç i ka paraqitur në ofertën e tij; të mos mbyllë zyrat e Bankës së Kursimeve sh.a. që specifikohen në shtojcën përkatëse të Kontratës, për afatin që përcaktohet në shtojcë; të mos e rishesë Bankën e Kursimeve ose ndonjë interes në të pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

Zotimet e shitësit

Shitësi merr përsipër detyrimet sipas zakonit të mirë tregtar dhe, gjithashtu, merr përsipër që midis datës së lidhjes së Kontratës dhe transferimit të aksioneve: të drejtojë veprimtarinë e Bankës së Kursimeve sipas rrjedhës normale të biznesit; të bëjë përpjekje maksimale për të mbajtur të pacenuar organizimin e biznesit, klientët dhe personelin; të lejojë blerësin dhe përfaqësuesit e tij të autorizuar të kenë hyrje të plotë në të gjitha pronat, aktivet, informacionet financiare dhe arkivat; të respektojë legjislacionin dhe rregulloren që ka lidhje me të.

Detyrimet përfundimtare të shitësit

Përfundimisht, për kalimin e aksioneve shitësi detyrohet: të japë mendimin e Ministrit të Drejtësisë se ai ka zotësi juridike të plotë për të vepruar për lidhjen dhe zbatimin e kushteve të Kontratës

Detyrimet përfundimtare të blerësit

Përfundimisht, për kalimin e Aksioneve, blerësi detyrohet: të paguajë çmimin e shitjes së aksioneve dhe të përmbushë të gjitha detyrimet e tjera të parashikuara në kontratë; të ketë marrë lejen për zhvillimin e veprimtarive bankare dhe të gjitha miratimet e tjera të nevojshme nga Banka e Shqipërisë; të marrë mendime juridike nga vendi i tij dhe këshilltarë ligjorë shqiptarë për zotësinë juridike për të vepruar si blerës dhe për lidhjen e Kontratës e zbatimin e kushteve të saj. Këshilltari ligjor shqiptar i blerësit ka të drejtë të mbështetë mendimin e tij mbi opinionin e këshilltarit ligjor të blerësit nga vendi i tij.

Ligj i zbatueshëm

Kontrata formohet dhe rregullohet sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Zgjidhja e
mosmarrëveshjeve
dhe ekzekutimi i
vendimeve

Mosmarrëveshjet ose pretendimet që do të dalin në lidhje me Kontratën do të zgjidhen me arbitrazh, sipas procedurave të UNCITRAL. Arbitrazhi do të kryhet me një arbitër dhe emërimi i tij do të bëhet nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Londrës. Vendi i arbitrazhit do të jetë Londra, Angli dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Vendimet e formës së prerë të arbitrazhit do të ekzekutohen në çdo juridiksion kompetent.

V E N D I M
Nr.457, datë 28.6.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.403, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RRRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përbushje të detyrës gjatë fluturimit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.403, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si vijon:

“Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, me datë fillimi deri më 30.6.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 për qind.”.

2. Pika 2 riformulohet si vijon:

“Pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, me datë fillimi deri më 30.6.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 për qind.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Illir Meta

V E N D I M
Nr.458, datë 28.6.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””, NDRYSHUAR
ME LIGJET NR.7392, DATË 17.5.1995; NR.8286, DATË 16.2.1998; NR.8392, DATË
2.9.1998; NR.8575, DATË 8.2.2000; NR.8776, DATË 26.4.2001 DHE LIGJIT NR.7870, DATË
13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- Në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 1. Në kapitullin III pika 6 paragrafi i dytë fjalia e parë, shprehja “ata vetë” zëvendësohet me shprehjen “më vete”.
 2. Në kapitullin IV pika 1 paragrafi i parë, bëhen këto ndryshime:
 - Fjala “të qarkut” hiqet.
 - Shprehja “me certifikatën e gjendjes civile, me fotografi të personit ose ortakëve” zëvendësohet me “me certifikatën e gjendjes civile me fotografi të personit ose ortakëve”.
 3. Në kapitullin V bëhen këto ndryshime:
 - Paragrafi i dytë fjalia e dytë riformulohet si vijon:
“Afati i pagesës së kontributeve, të llogaritura mbi pagat e muajit paraardhës është jo më vonë se dita e fundit e muajit pasardhës.”.
 - Në paragrafin e tretë, fjala “të qarkut” hiqet.
 - Në paragrafin e gjashtë fjalia e parë, shprehja “i paguajnë vetë” zëvendësohet me shprehjen “i paguajnë individualisht”.
 - Paragrafi i shtatë riformulohet si vijon:
“Detyrimi ndaj Sigurimeve Shoqërore përfaqëson shumën e llogaritur nga administrata e Sigurimeve Shoqërore për kontributet e papaguara brenda afateve të përcaktuara më lart. Pas datës 1.1.2001, e në vazhdim, detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore përfaqëson shumën e kontributeve të papaguara, brenda afateve ligjore dhe shumën e kamatvonesave të arrira të llogaritura mbi kontributet e paderdhura brenda afateve ligjore, gjatë vitit të mëparshëm”.
 4. Në kapitullin VII pika 2 fjalia e parë, pas fjalës “Personat” shtohet shprehja “që përfitojnë të ardhura nga papunësia, detyrohen që”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M

Nr. 459, datë 28.6.2001

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR NDËRMINISTROR TË LUFTËS KUNDËR HIV/AIDS (SIDA)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8689, datë 16.11.2000 “Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e rregullores “Për funksionimin e Komisionit Kombëtar Ndërmintor të luftës kundër HIV/AIDS (SIDA)”, e cila bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR NDËRMINISTROR TË LUFTËS
KUNDËR HIV/AIDS

Në mbështetje të ligjit nr.8689, datë 16.11.2000 “Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr.64, datë 21.5.2001 “Për ngritjen e Komisionit Kombëtar Ndërmintor të luftës kundër HIV/AIDS” (SIDA) pika nr.2, hartohet kjo rregullore mbi detyrat dhe funksionet kryesore të këtij Komisioni.

Neni 1
Legjitimiteti

Komisioni Kombëtar Ndërmintor i luftës kundër HIV, AIDS ngrihet në mbështetje të ligjit dhe urdhrit të mësipërm.

Neni 2
Detyrat dhe funksionet

Detyrat kryesore të këtij Komisioni që bazohen në ligjin nr.8689, datë 16.11.2000 “Për parandalimin e përhapjes së infeksioneve HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë”, në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), si dhe në situatën epidemiologjike të HIV/AIDS në vend, janë:

- T’i propozojë Këshillit të Ministrave marrjen e vendimeve përkatëse për parandalimin dhe luftimin e sëmundjes së HIV/AIDS (SIDA).
- Të hartojë planet vjetore të veprimtarisë për parandalimin e HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë, duke orientuar dikasteret, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e tyre.
- Të iniciojë dhe mbështesë programe kombëtare në fushën e parandalimit, si dhe nisma të tjera në planin teknik dhe shkencor për përmirësimin e survejancës së HIV/AIDS, të mjekimit adekuat, si dhe të mbështetjes psikologjike dhe sociale të personave me HIV/AIDS.
- Të nxisë dhe mbështesë shkëmbimin e informacionit me OBSH-në dhe vendet e tjera.
- Të sigurojë informimin e rregullt të popullsisë, duke përdorur të gjitha format dhe mjetet legale të komunikimit masiv lidhur me masat parandaluese të infeksionit të HIV/AIDS, duke bashkëpunuar për këtë edhe me OJQ-të e ndryshme, që kanë për objekt këtë fushë veprimi.
- Të insistojë në një pjesëmarrje dhe tërheqje të gjerë të rinisë shkollore në programet e edukimit moral dhe seksual, zhvillimin e programeve të promocionit dhe të edukimit shëndetësor për formimin e arsimtarëve, edukatorëve dhe të personelit shëndetësor.
- Të informojë sistematikisht mbi punën e bërë Këshillin e Ministrave, të propozojë marrjen e masave dhe vendimeve përkatëse dhe të kërkojë mbështetje financiare për zbatimin e programeve në fushën e studimit të gjendjes së HIV/AIDS të fushatave të promocionit dhe të edukimit për parandalimin e këtij infeksioni etj.

Neni 3

Komisioni kërkon nga dikasteret, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, marrjen e masave dhe përcaktimin e detyrave me karakter social-ekonomik të promocionit dhe edukimit, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve shëndetësore dhe të ndërgjegjësimit të publikut e veçanërisht të rinisë për rreziqet që mbart HIV/AIDS, si dhe për mbështetjen dhe mbrojtjen ligjore të pacientëve të prekur nga ky infeksion.

Neni 4 **Funksionimi**

1. Komisioni zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi në këtë rregullore dhe në parimet e normat demokratike të afirmuara në jetën e organizmave kolegjiale.

2. Komisioni mbledhet periodikisht sipas njoftimit të bërë nga Kryetari i tij, por jo më pak se 4 herë në vit. Njoftimi përfshin dërgimin e rendit të ditës dhe të materialeve të parapregatitura (raporte, analiza, informacione etj.), duke ia vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve, të paktën 1 javë para datës së mbledhjes.

3. Qëndrimet, orientimet dhe porositë për çështjet e diskutuara, Komisioni i shpreh me vendimet që miraton me shumicë votash.

4. Komisioni i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Për arsye objektive, mbledhjet e Komisionit mund të shtyhen por jo më vonë se 15 ditë nga data e përcaktuar. Mbledhja e Komisionit mund të realizohet edhe para afatit me konsensus, me kërkesën e Kryetarit apo të ndonjë anëtari, kur problematika e kërkon atë.

5. Kur numri i votave për marrjen e një vendimi është ndarë në mënyrë të barabartë, vendos vota e kryetarit të Komisionit.

6. Në mbështetje të Komisionit Kombëtar Ndërmintor krijohet grupi i specialistëve, që propozohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe miratohet nga Komisioni. Specialistët përzgjidhen nga dikasteret, institucionet qendrore dhe shëndetësore. Përbërja dhe numri i këtij grupi përcaktohet me vendim të Komisionit Ndërmintor të Luftës Kundër HIV/AIDS.

Neni 5 **Kryetari i Komisionit**

Kryetari i Komisionit ka këto të drejta dhe detyra:

- Drejton mbledhjet e Komisionit.
- Vendos për rendin e ditës dhe datën e mbledhjes së Komisionit.
- Organizon konsulta paraprake me anëtarët e Komisionit.
- Ngarkon me detyra të veçanta anëtarët në kuadër të zbatimit të vendimeve.
- Thërret në takime të veçanta anëtarët për t'u informuar për ecurinë e punëve.
- Vendos për thirrjen e ekspertëve dhe specialistëve për t'u dëgjuar në Komision.
- Nënshkruan vendimet e Komisionit.

Neni 6 **Sekretaria**

1. Organizon dhe drejton veprimtarinë për:

- përgatitjen me nivel të mbledhjeve;
- njoftimin e anëtarëve dhe të ftuarve në mbledhje;
- shpërndarjen e rendit të ditës dhe materialet e përgatitura;
- kujdeset për përgatitjen e projektvendimeve që do të paraqiten për miratim në Komision.
- koordinimin e punës me institucionet që janë ngarkuar me problemet e HIV/AIDS për përgatitjen në kohë të materialeve për mbledhjen e Komisionit dhe për zbatimin e vendimeve të marra;

- Ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit mbi veprimtarinë e këtij Komisioni.

2. Sekretaria sigurohet nga Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor në Ministrinë e Shëndetësisë.

Neni 7 **Anëtarët e Komisionit**

Në mbledhje anëtarët e Komisionit janë të barabartë.

Anëtari ka të drejtë:

- të bëjë pyetje;
- të kërkojë sqarime për materialet e paraqitura;
- të ngrejë probleme në interes të punës së Komisionit;
- të sugjerojë rend dite për mbledhjet e Komisionit;
- të marrë përsipër detyrimet e dikasterit që përfaqëson për problemet përkatëse të veprimtarisë së Komisionit.

Neni 8

Anëtarët e Komisionit për punën e kryer dhe pjesëmarrjen në mbledhje shpërblehen me 5000 lekë për çdo mbledhje. Me vendim të Komisionit, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për pjesëmarrje në mbledhje, të shpërbëhen edhe anëtarët e grupit të specialistëve.

Shpenzimet përballohen nga fondet e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr. 58, datë 3.7.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË "

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	" "
Gjergj Sauli,	Anëtar i	" "
Alfred Karamuço,	Anëtar i	" "
Kujtim Puto,	Anëtar i	" "
Kristofor Peçi,	Anëtar i	" "
Petrit Plloçi,	Anëtar i	" "
Tefta Zaka,	Anëtar i	" "
Sokol Sadushi,	Anëtar i	" "

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 3.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 70 Akti që i përket:

K ë r k u e s: Elmaz Sherifi

Subjekte të interesuara:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. Komisioni i Zonës Zgjedhore nr. 57, përfaqësuar nga kryetari, zoti Zylyftar Çoku.
3. Zamir Balliu, përfaqësuar nga avokat Shaqir Hasani.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i pavlefshmërisë së vendimit nr.008, datë 30.5.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kryetarin e Fehmi Abdiu, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkesa e kërkuesit, kandidat për deputet i Partisë Socialiste në zonën zgjedhore nr.57, për shfuqizimin e vendimit nr.008, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e drejtë e duhet pranuar sepse ai komision ka mbështetur vendimin e tij mbi të dhënat e Komisionit Zgjedhor të Zonës nr.57, që nuk ka pasqyruar saktë rezultatin e votave të vlefshme për secilin kandidat.

Komisioni Zonal, para nxjerrjes së rezultatit përfundimtar për secilin kandidat që kanë konkurruar gjatë fushatës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë ka administruar, ndër të tjera, një tabelë (procesverbal) fiktiv, sipas të cilit kërkuesi në qendrën e votimit nr.3 kishte fituar vetëm 4 vota. Në të vërtetë, sipas (procesverbalit) tabelës origjinale për atë qendër votimi, kërkuesi ka fituar 27 vota. Duke u mbështetur në procesverbalin e pasaktë, Komisioni Zonal Zgjedhor ka arritur në përfundimin se kërkuesi dhe subjekti i interesuar, zoti Zamir Balliu, kandidat për deputet, i pavarur, do t'i nënshtrohet raundit të dytë të zgjedhjeve. Ky vendim është miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin e tij nr.008, datë 30.6.2001, sipas të cilit nuk është njohur fitues asnjë kandidat për deputet dhe është urdhëruar zhvillimi i raundit të dytë të zgjedhjeve.

Gjatë shqyrtimit të çështjes është konstatuar se vendimi i lartpërmendur është i pabazuar e si i tillë ai duhet të shfuqizohet.

Me procesverbalin origjinal të qendrës së votimit nr.3, është vërtetuar se kërkuesi ka fituar 27 vota. Ky fakt është vërtetuar edhe me vërtetimin e datës 30.6.2001 të Komisionit Zonal Zgjedhor nr.57, sipas të cilit pas hapjes së kutisë së votimit nr.3, verifikimit të tabelës së rezultateve të votimit, ka rezultuar se kërkuesi ka patur 27 vota.

Me vërtetimin e nënshkruar nga Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Ilirjan Celibashi, është vërtetuar se, mbi bazën e ankimit të kërkuesit, meqenëse është konstatuar se Komisioni Zonal Zgjedhor nuk kishte verifikuar ankesën e tij, është urdhëruar verifikimi i tabelës së rezultateve për qendrën e votimit nr.3, nga ku ka rezultuar se numri i votave për kërkuesin është 27.

Duke qenë çështja sa më lart, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duhet të shfuqizohet sepse nuk pasqyron realitetin në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për zonën nr.57 lidhur me kërkuesin. Është detyrë e atij komisioni që të rimblidhet për të rivlerësuar këtë fakt e për të rivendosur, pasi, ashtu siç ka pretenduar, kërkuesi ka dalë fitues që në raundin e parë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/e të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, me shumicë votash

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.008, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Dërgimin e çështjes pranë atij organi për ta shpallur kërkuesin fitues. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

NDREQJE GABIMESH

Në Fletoren Zyrtare nr.24/2001, në ligjin nr.8776, datë 26.4.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në faqen 736, neni 15, rreshti i dytë, fjala “ngritjen” duhet “ngrirjen”.

Në Fletoren Zyrtare nr.28/2001, në ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, në faqen 860, “Neni 12” bëhet “Neni 11/1”.

Në Fletoren Zyrtare nr.30/2001, në ligjin nr.8793, datë 10.5.2001, në titull fjala “Parashikimin” duhet “Parashkrimin” dhe ky ndryshim bëhet edhe te përmbajtja.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 11.7.2001
Doli nga shtypi më 13.7.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë